# MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN FARKË, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Farkë, Tiranë, me objekt: "Mbi zbatimin e ligjit buxhetit të shtetit dhe atij lokal, gjatë hartimit dhe miratimit të buxhetit vendor dhe përdorimi efektiv i fondeve buxhetore sipas planit dhe llojit. Prokurimet e fondeve publike për mallra dhe shërbime. Proçedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve dhe lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit etj" dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.33 , datë 12.03.2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 431/7, datë 12.03.2012, dërguar **z. Fatbardh Plaku,** Kryetar i komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

## A. MASA ORGANIZATIVE

### I. Për Njësinë e Prokurimit.

**1.** Në zbatim të kërkesave të pikës 2, shkronja *"a"* Kreu V të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, njësia e prokurimit, në hartimin e dokumenteve të tenderit të ketë parasysh përcaktimin e kritereve për kualifikim duke argumentuar me hollësi natyrën dhe vëllimin e punimeve.

**Vazhdimisht**

**2.** Me urdhër të veçantë të titullarit të Autoritetit Kontraktor të ngrihet komisioni i vlerësimit të ofertave për të gjithë vitin dhe jo rast pas rasti sikurse është vepruar deri tani, në zbatim të kërkesave të pikës 2, shkronja "ç" Kreu V të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar.

**Menjëherë**

**3.** Në përcaktimin e afatit kohor të garancisë së punimeve të ndërtimit, për objektet me destinacion përdorimi afatgjatë, të mbahen parasysh kërkesat e nenit 866 të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

**Vazhdimisht**

**4.** Në zbatim të kërkesave të pikës 1, neni 38 Kreu dhe pikës 4 neni 12 të LPP dhe pikës 3, shkronja "ë" Kreu I të VKM nr.1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", nga Autoritetit Kontraktor, të dërgohen në APP regjistrat e parashikimit dhe të realizimit të prokurimeve publike si dhe raporti 4 mujor mbi veprimet e prokurimit.

**Vazhdimisht**

**5.** Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", nga Autoritetit Kontraktor, të inventarizohet dokumentacioni i dosjeve të prokurimeve publike sipas renditjes kronologjike të kryerjes së procedurave.

**Vazhdimisht**

**6.** Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat"dhe të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, nga sektori urbanistik të inventarizohet dokumentacioni i dosjeve të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit sipas renditjes kronologjike të zbatimit të tyre.

**Vazhdimisht**

### II. Për Kryetarin e Komunës:

Në zbatim të nenit 40 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 për "Planifikimin e Territorit", Kryetari i Komunës ti paraqes Këshillit të Komunës, kërkesën për nisjen e procesit, për hartimin e instrumentit vendor të planifikimit, i cili të përmbaj:

**a.** studimin që përcakton faktet dhe analizon problemet për instrumentin e paraqitur për shqyrtim dhe përmbledhjen e vërejtjeve apo propozimeve të palëve të interesuara;
**b.** kufijtë e territorit, për të cilin hartohet instrumenti vendor i planifikimit;
**c.** planin e veprimeve për sigurimin, sipas rastit, të bashkërendimit horizontal e vertikal dhe përfshirjen e palëve të interesuara.

**Menjëherë**

**II. Për Këshillin e Komunës**:
**1.** Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit",o ndryshuar Këshilli i Komunës të miratoj projektin e instrumentit vendor të planifikimit ose ta rikthej për ripunim atë me vërejtjet përkatëse, në rastet kur vlerëson se:
- nuk janë kryer bashkërendimi, këshillimi dhe dëgjimi publik ose nuk janë respektuar procedurat e tjera të detyrueshme të planifikimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- projekti ka mospërputhje me instrumentet e planifikimit ose me legjislacionin në fuqi.

**Menjëherë**

**2**. Këshilli i Komunës të miratoj rregullat e kontrollit të zhvillimit, sipas rëndësisë e natyrës së çështjeve, në përputhje me rregulloret uniforme të kontrollit të zhvillimit dhe rregulloret kombëtare të kontrollit të zhvillimit.

**Menjëherë**

**III. Për Autoritetin Përgjegjës i Planifikimit** .
**1**.Autoriteti përgjegjës i planifikimit të mos pranojë kërkesa për leje zhvillimi pa paraqitur më parë Pëlqimin Mjedisor të Agjensisë Rajonale të Mjedisit të Qarkut Tiranë, në mbeshtetje të ligjit nr. 8934 datë 05.09.2002 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" i ndryshuar.

**Vazhdimisht**

**2.** Autoriteti përgjegjës i planifikimit të pranojë dhe të shqyrtojë kërkesat për leje përdorimi vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes, sipas fazave të përcaktuara në rregulloret e kontrollit të zhvillimit.

**Në çdo rast**

**3**. Autoriteti përgjegjës i planifikimit të mos pranojë dhe të mos shqyrtojë kërkesat për *Leje Përdorimi* kur ka mos zbatim të projektit të miratuar në lejen e ndërtimit, në zbatim të pikës "ç" të nenit 11 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar dhe në zbatim të udhëzimit nr.3 datë, 15.2.2001 "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"

**Në çdo rast**

**4.** Autoriteti përgjegjës i planifikimit, të mos pranoj dhe të mos shqyrtoj kërkesa për leje përdorimi për subjektet ndërtuese, pa pasur më parë një vërtetim nga Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik i Komunës që të vërtetojë shlyerjen e gjobave të vendosura nga INU i Komunës.

**Në çdo rast**

**5.** Nga ana e specialistit të zyres së urbanistikes, të bëhet plotësimi i formularit të përllogaritjes për 15 muaj me vonesë, për subjektin ndërtues dhe njëheresh investitor shoqeria [redacted] për pagesen e investimit sipas kostos mesatare të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave, në përputhje, me nenin 9 të ligjit nr.10078, datë 16.02.2009 "Për Urbanstikën".

**Menjëherë**

**IV. Për Inspektorati Ndërtimor Urbanistik pranë Komunës**.

**1.** Për punimet e kryera pa leje ose në shkelje të kushteve të lejes, sipas ligjit, autoritetet e inspektimit, krahas dënimit për kundërvajtjet e konstatuara, ti kërkojnë kundërvajtësit të paraqesë

pranë autoritetit përgjegjës të planifikimit, një kërkesë për pajisjen me leje të punimeve të paligjshme ose të kryera në shkelje të kushteve të lejes fillestare.

**Vazhdimisht**

**2.** Në çdo rast kundërvajtësi të paraqes, së bashku me kërkesën për zhvillim, dokumentin që vërteton pagimin e gjobës së vënë, brenda 30 ditëve nga data e vendimit për kundërvajtjen administrative, në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit" i ndryshuar,

**Vazhdimisht**

**3.** Kryeinspektori INU Komunës Farkë në të gjitha rastet kur është mbatjur proçes-verbale konstatim kundravatje  për objektet pa leje ndërtimi dhe shtesa kati pa leje ndërtimin mbi objektet ekzistuese, duhet vazhduar proceduara ligjore për pezullim punimi, për vendim gjobe dhe për vendim prishje objekti.

**Vazhdimisht**

**IV. Për Zyrën e Financës dhe Zyren Tatim Taksa.**

**1.** Nga Sektori i Financës dhe i Shërbimeve të merren masa për kryerjen e procedurave për kthimin në skrap të  automjetit  të llojit fadromë tip benz,vlerësimin e tij, dokumentimin dhe bërjen hyrje në magazinë. Të bëhet kontabilizimi  i këtij veprimi dhe përfshirja në pasqyrat financiare.

**Menjëherë**

**2.** Për rritjen e efiçencës te menaxhimit të fondeve për kryerjen e funksioneve të veta kjo njësi vendore në përputhje me ligjin organik të buxhetit dhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore të realizojë:
-Parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të argumentuara mbi një bazë reale dhe të përcaktojë drejt prioritetet e projekteve.
-Monitorimin e ecurisë projekteve investimeve, analizën faktoriale të realizimit të tyre në mënyrë të vazhdueshme dhe marrjen e masave për eliminimin e faktorëve negativ.
-Të bëjë rishikimin e buxhetit gjatë vitit dhe në rastet kur fondet janë të pamjaftueshme dhe ecuria e projekteve nuk është e kënaqshme duhet të ndryshojë prioritetet.

**Vazhdimisht**

**3**. Nga ana e  Zyrës së Tatim Taksave, t'i dërgohet sektorit të financës lista e debitorëve për taksën lokale në fund të vitit me qëllim regjistrimin  e tyre  në kontabilitet dhe ndjekjen në vazhdimësi të tyre.

**Menjëherë**

**4.** Përdorimi i fondit për ndihmë ekonomike të jetë i hollësishëm dhe i shoqëruar në çdo rast me dokumentacionin e nevojshëm justifikues duke dhënë argumentim të detajuar sa herë që përdoret.

**Vazhdimisht**

**5.** Të programohen me kujdes shpenzimet operative në drejtim të uljes së tyre pa cenuar nevojat për to, me qëllim që këto fonde jo vetëm të mos bllokohen, por të orientohen në përdorimin e tyre për investime.

**Vazhdimisht**

**6.** Nga Zyra e Tatim Taksave të merren të gjitha masat për ndjekjen dhe arkëtimin e tarifave dhe taksave vendore, gjithashtu të bëhet një parashikim sa më real duke shfrytëzuar mundësitë reale të territorit të komunës.

**Vazhdimisht**

**7.** Të merren masa nga Sektori i Tatim Taksave që të ardhurat nga biznesi i vogël dhe biznesi i madh të planifikohen pa rezerva dhe të realizohen sipas miratimit të Këshillit të Komunës.

**Vazhdimisht**

**8.** Të merren masa nga Sektori i Tatim Taksave që në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" të bëhet inventarizimi i dosjeve të subjekteve të biznesit të vogël dhe të biznesit të madh.

**Vazhdimisht**

**9.** Të marren masa nga Sektori i Tatim Taksave që në dosjet e biznesit të vogël dhe të biznesit të madh të plotësohet deklarata e parashikimit qarkullimit vjetorë si dhe të ndahet në keste detyrimi vjetor dhe të njoftohen zyrtarisht tatimpaguesit para datës 1 mars të çdo viti ushtrimorë.

**Vazhdimisht**

**B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Të kërkohen në rrugë ligjore dëmet ekonomike të shkaktuar buxhetit të shtetit në vlerën ***1,372,732 lekë***, pasi nga kontrolli i dokumentacionit teknik të zbatimit, i administruar në dosjen teknike, u konstatuan diferenca në zëra dhe volume pune të pakryera në fakt.

Operatorët ekonomikë janë:

**1.** [redacted] sh.p.k. për vlerën 247,500 lekë për objektin "Rikonstruksion i rrugës Lagja Xhafbazaj-shkolla Eurolingua",

**2**. [redacted] sh.p.k**.** për vlerën 1,125,232 lekë për objektin "Ndërtim ujësjellësi faza II, depo e it Farkë".

**C. MASA ADMINISTRATIVE**

Në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 15.02.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" i ndryshuar, Kreu III-të "Sanksionet" nenet 15 e 16, Komuna të kërkojë nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik pranë saj, të gjobisë mbikëqyrësit e punimeve të ndertimit edhe kolaudatorin si më poshtë:

Për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik, veprimet e kryera prej tyre bien në kundërshtim me nenin 4, paragrafi parë, Kreu II-të, neni 7 paragrafi tretë, neni 8 paragrafi dytë, neni 9 paragrafi tretë shkronja "c" dhe neni 12 paragrafi parë pikat 1,2,3 dhe 4 të Kreut III-të, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Mbi kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit", me ndryshime; me piken 4 paragrafi tretë, pika 5/c dhe 15 paragrafi i dytë, pika 17 dhe 19 të Kreut I-rë, pikat 3/a, 3/b dhe 3/c të Kreut II-të të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" dhe pikat 3/4, 7, 7/1 dhe 7/3 Kreu I-rë dhe pikat 2, 2/1 dhe 4 të Kreut III-të të udhëzimit KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndertimit".

**1**. Ing**.** [redacted] në cilësinë e mbikëqyrësit, në objektin "Ndërtim ujësjellësi faza II, depo e ujit Farkë", gjobë në masën 50,000 lekë, për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën prej 1,125,232 lekë pasi:

Nga kontrolli dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, në projekt zbatim, preventiv oferte me ndryshimet e pasqyruara, libër masash, kontroll fizik në vend për realizimin në fakt të vëllimeve të punës së kryer dhe krahasimi i tyre me situacionin përfundimtar për pagesë u

konstatuan diferenca në plus dhe përfitime më tepër në zërat e punimeve, në vlerën 1,125,232 lekë .

**2**. Ing.[redacted]., në cilësinë e mbikëqyrësit, në objektin "Sistemim asfaltimi i rrugës Fikas Qeha Shytaj Hekal gjobë në masën 50,000 lekë, për dëmin ekonomik të shkaktuar në vlerën prej 247,500 lekë pasi:

Nga kontrolli dhe shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, në projekt zbatim, preventiv oferte me ndryshimet e pasqyruara, libër masash, kontroll fizik në vend për realizimin në fakt të vëllimeve të punës së kryer dhe krahasimi i tyre me situacionin përfundimtar për pagesë u konstatuan diferenca në plus dhe përfitime më tepër në zërat e punimeve, në vlerën 247,500 lekë.

**3**. Ing.[redacted]në cilësinë e mbikëqyrësit, në objektin "Shtesë punimesh në objektin rikonstruksioni rrugës rruga e Elbasanit-Mjull-Bathore (kryqëzim)", gjobë në masën 100,000 lekë, për mos dorëzimin e dosjes.

4. Ing. [redacted] në cilësinë e kolaudatores në objektin "Shtesë punimesh në objektin rikonstruksioni rrugës rruga e Elbasanit-Mjull-Bathore", gjobë në masën 300,000 lekë, për kolaudimin e objektit dhe likuidimi i situacionit përfundimtar pa dosjen e objektit.

## D. MASA DISIPLINORE

**A.** Mbështetur në nenet 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës" i ndryshuar, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

***"Vërejtje me paralajmërim" për:***

**1**. [redacted] me detyrë zv-kryetar i komunës dhe në cilësinë e kryetarit të komisionit të vlerësimit të ofertave për shkeljet e konstatuara në plotësimin e dokumentacionit të procedurave të prokurimeve publike.

**2**. [redacted] me detyrë jurist i komunës dhe në cilësinë e juristit në njësinë e prokurimit për shkeljet e konstatuara në procedurat e hartimit të dokumenteve të prokurimeve publike.

**3**. [redacted] me detyrë përgjegjëse e zyrës të financës dhe në cilësinë e anëtares të komisionit të vlerësimit të ofertave, për shkeljet e konstatuara në plotësimin e dokumentacionit të procedurave të prokurimeve publike.

**4.** [redacted]me detyrë drejtor i urbanistikës, për mos zbatim të nenit 22/1 të ligjit nr. 8405 datë 17.09.1998 "Për Urbanstikën" i ndryshuar, të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" t ndryshuar dhe të VKM nr. 722, datë 19.11.1998 "Për miratimin e Rregullores së Urbanistikës" i ndryshuar.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Seit Spahiu, Halil Isufi, Irma Shkupi, Tatjana Shurbi dhe Skënder Hajdari. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**